

## Haradinaj kërkon përkrahjen e Francës për INTERPOL dhe UNESCO



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



XHEVË KRASNIQI-LLADROVCI, FIGURË E SHQUAR E LUFTËS ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS F. 11



AGIM VINCA

FAIK E BESIM UKËHAXHAJ, RËNIA DHE PËRKUJTIMI F. 11

SHKËLZEN UKËHAXHAJ

HOXHA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE 48 MILIONË EURO ME KOMISIONIN EVROPIAN F. 11

### EKONOMI

GËRXHALIU: KOSOVA URGJENTISHT DUHET TË APLIKOJË PËR ANËTARËSIM NË OBT F. 9

UJËSJELLËSI NË MUAJIN MAJ KA SHKYÇUR 174 KONSUMATORË BORXHLINJ F. 9

### SPORT

PRISHTINA, 'KAMPIONE' E TRANSFERIMEVE F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAGMI MUSTAFA F. 4-5

## Serbia, përveç njohjes së shtetit të Kosovës, s'ka rrugë tjetër

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka thënë se bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund të zgjasin deri në pafundësi. Ai ka bërë me dije se ka ardhur koha që dialogu të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka deklaruar se Serbia nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së shtetit të Kosovës. Ai ka treguar se gjendja në Luginën e Preshevës nuk ka ndryshuar meqë nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve. Mustafa ka thënë se shqiptarët janë në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë

## Veseli: Është koha që PDK-ja të ndryshojë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se partia që drejton nuk do të largohet asnjëherë nga vlerat e veta, por do të punojë gjithmonë për të ndryshuar aty ku duhet, veten dhe Kosovën. Në një

konferencë për medie, në të cilën ka folur për procesin zgjedhor në Rininë Demokratike, ai ka theksuar thënë se PDK-ja është partia me besimin më të madh qytetar. "Është koha të ndryshojë edhe PDK-ja, të hapët edhe më shumë



për çdo individ, çdo profesion, për ata që angazhimin politik e shohin si mision për vendin e jo për veten", ka Veseli F. 7



## Kërkohet përkujdesje më e madhe për fëmijët

Me aktivitete të ndryshme është shënuar të premten në Kosovë 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Rreth 400 fëmijë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga e

gjithë Kosova, kanë vizituar Kuvendin e Kosovës, kurse përfaqësuesit e institucioneve janë zotuar se do të krijojnë kushte dhe mjedis më të mirë për fëmijët F. 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Rama, takim me Tsiprasin dhe Zaevin në Prespë?

TIRANË, 1 QERSHOR - Edi Rama, Aleksis Tsipras dhe Zoran Zaev do të takohen së shpejti në Prespë, zonë kjo që ndahet mes tre shteteve Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë. Siç kanë njof-

tuar disa medie, ky takim do të ketë për qëllim zgjidhjen përfundimtare të disa prej çështjeve që qëndrojnë të hapura midis këtyre shteteve fqinje, siç është edhe emri i Maqedonisë.

Pjesëmarrja e Ramës në këtë takim shihet si garanci për pranimin e marrëveshjes, asaj të emrit me Greqinë, edhe nga shqiptarët e Maqedonisë. Tre liderët do të fokusohen

edhe në bashkëpunimin dhe sigurinë e rajonit, ku përfshihet siguria energjetike apo mbështetja për "Rrugën e mëndafshit", një projekt gjigant i financuar nga Kina.



# Riformatohet kabineti qeveritar në Maqedoni

Katër vende ministrash dhe po aq zëvendësministra ndryshojnë në kabinetin e kryeministrit Zaev. Koalicioni qeveritar zgjerohet me njërin krah të Lëvizjes "Besa", me Partinë Demokratike Shqiptare dhe Lidhjen e Romëve



SHKUP, 1 QERSHOR - Parlamenti i Maqedonisë ka diskutuar mbi propozimet e kryeministrit Zoran Zaev për riformatimin e kabinetit të tij qeveritar. Katër vende ministrash dhe po aq zëvendësministra ndryshojnë në kabinetin e tij. Koalicioni qeveritar zgjerohet me njërin krah të Lëvizjes "Besa", me Partinë Demokratike Shqiptare dhe Lidhjen e Romëve.

Asaf Ademi i Lëvizjes Besa, krahu i Shkupit, siç njihet në opinionin publik, do ta drejtojë Ministrinë e Kulturës, ndërsa Bardhyl Dauti i PDSH-së si ministër pa portofol. Ndërkaq, Bashkimi Demokratik për Integrim dhe Lidhja Social Demokrate shkëmbejnë postet e ministrave të Drejtësisë dhe të Arsimit. Renata Deskoska e LDSM-së nga Arsimit do të kalojë në Drejtësi prej nga është larguar para pak muajsh Bilën Saliji

(BDI), ndërsa Arbër Ademi i BDI-së nga zëvendësministër bëhet ministër i Arsimit dhe Shkencës. Kryeministri Zaev gjatë ekspozesë në parlament, duke folur për nevojën e ndryshimeve në kabinet, tha se "krizën e thellë politike po e lëmë pas vetes duke hapur procese serioze reformash për ta kthyer besimin tek institucionet dhe ambienti demokratik". Ai shtoi se vendi

nga izolimi me tensione të mëdha politike arriti te pragu i anëtarësimit të vërtetë në NATO dhe të një datë e pritshme për bisedime me Bashkimin Evropian.

Zaevi vlerëson se propozimet për ministrat e rinj janë të duhur dhe me kapacitet për ta kryer detyrën e tyre me sukses. Por, opozita e drejtuar nga VMRO-DPMNE kërkon dorëheqjen e kryemi-

nistrit sepse, sipas saj, po e çon vendin drejt gremisë dhe po "shet interesat shtetërorë të Maqedonisë".

Ata cituan Zaevin të jetë shprehur para shumë muajsh se "në kabinetin e tij ka ministra të cilët nuk dinë të punojnë, të tjerë që nuk duan dhe të tretë që nuk dinë, por duan të mësojnë" dhe, së këndejmi, ligjvënësit e VMRO-së kërkojnë llogari dhe përgjigje

nga kryeministri maqedonas se kush janë këta ministra dhe pse vazhdon t'i mbajë në kabinetin e tij qeveritar. VMRO-ja e quan këtë si "riformatim pazaresh", pa përmbajtje dhe mesazhe politike. Votimi për ministrat e rinj duhet të bëhet të premtën deri para mesnate. Nëse ata miratohen më herët, atëherë parlamenti do ta hapë debatin edhe për zëvendësministrat.

## BDI: Kemi realizuar pesë premtimet kryesore

SHKUP, 1 QERSHOR - BDI-ja beson se ka realizuar pesë shtyllat kryesore nga premtimet parazgjedhore gjatë këtij njëvjetori të qeverisjes. Ata shprehen të kënaqur nga puna e deritanishme në ekzekutiv duke shtuar se u mbeten edhe tre vjet të tjera për përmbushjen e premtimeve të mbetura. Pesë shtyllat zgjedhore të BDI-së në zgjedhjet e 2016-s ishin barazia ekonomike, vendimarrja konsensuale, shqipja zyrtare në tërë territorin, sundimi i shtetit ligjit dhe anëtarësimi në NATO. "Vlerësoj se shumica

e premtimeve tona zgjedhore nga programi të cilin e kemi premtuar në zgjedhjet e 2016-s, në veçanti pesë premtimet kryesore që i kishim, janë realizuar siç është barazia gjuhësore, marrëveshja me fqinjën, Bullgarinë, avancimi dhe pothuajse përfundimi i negociatave me fqinjën tonë, Greqinë dhe zhvillimin ekonomik. Sa iu takon projekteve infrastrukturore, duhet t'ju përkujtoj juve dhe qytetarëve se kjo qeveri ka mandat katërvjeçar dhe është e përbërë nga partnerët e koalicionit", deklaroi Artan Grubi,

anëtar i Kryesisë së BDI-së.

Grubi pranon se çështja e fuqizimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve mund të mbetet në këtë gjendje deri në përfundimin e mandatit të presidentit Gjorge Ivanov në vitin e ardhshëm. A do të thotë kjo se edhe për tetë muaj të tjerë ky mund të quhet një premtim i parealizuar? "Jo, absolutisht jo. Sepse atë që e kemi premtuar ne, tashmë e kemi realizuar. Ne e miratuar në Kuvend jo një herë, por tri herë. Sa na takon neve, ne e kemi përfunduar punën me Ligjin për

përdorimin e gjuhëve në Kuvend. Pritet zhbllokimi nga ana e vetëm një personi i cili, deshi apo nuk deshi, nuk ka edhe shumë kohë të rri aty ku është", u përgjigj Artan Grubi.

Sa iu takon premtimeve të cilat u shkruan në Deklaratën e përbashkët të partive shqiptare, por edhe në disa programe parazgjedhore të BDI-së, reth ndryshimit eventual të himnit, flamurit dhe simboleve shtetërore, Grubi thotë se si tema do të hapen deri në fund të këtij mandati. "Nuk e kemi shkopin



magjik që t'i zgjidhim të gjitha çështjet njëdekadëshe brenda një viti. Unë vlerësoj se në trevjeçarin e ardhshëm të kësaj qeverie do të hapen edhe këto tema dhe uroj që kohezioni shoqëror të cilin e ndërtojmë do të reflektojë edhe në tekstin e himnit, edhe në çështjet e tjera të cilat ju i ngrehët", tha Artan Grubi i BDI-së.



Sekretarja e Shtetit pranë ministrit të Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, ka vizituar Kosovën

## Haradinaj kërkon përkrahjen e Francës për INTERPOL dhe UNESCO

Sekretarja e Shtetit pranë ministrit të Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, ka bërë me dije se shteti francez do të jetë përkrahës i fuqishëm i të gjitha zhvillimeve në Kosovë. Në takim me kryeministrin Ramush Haradinaj ajo është zotuar për mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj evropiane. Ndërsa kryeministri Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e Francës në procesin e liberalizimit të vizave dhe anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL dhe UNESCO



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Sekretarja e Shtetit pranë ministrit të Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, ka siguruar kryeministrin Ramush Haradinaj që shteti francez edhe më tutje do të jetë përkrahës i fuqishëm i të gjitha zhvillimeve në Kosovë, me theks të veçantë atyre të sigurisë. Në takim me kryeministrin Haradinaj, ministrja franceze ka përshëndetur të arriturat në Kosovë që nga periudha e pasluftës, duke theksuar përkushtimin e Francës për mbështetjen e Kosovës në të gjitha proceset integruese. Ndërsa shefi i Qeverisë ka kërkuar mbështetjen e Francës për procesin e liberalizimit të vizave dhe anëtarësimin e

Kosovës në INTERPOL dhe UNESCO. "Pata kënaqësinë të bisedoj me sekretaren e shtetit pranë ministrit të Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, për proceset që po kalon vendi ynë, në veçanti për të arriturat në forcimin e sundimit të ligjit dhe për tranzicionin e FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës", ka treguar Haradinaj pas takimit me zyrtares e lartë franceze, duke shtuar se në rrugën e saj drejt BE-së dhe NATO-s, Kosova e sheh si partnere Francën. "Duke e falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme të Francës dhënë vendit tonë, kërkoja nga sekretarja Darrieussecq mbështetjen e shtetit francez për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL dhe UNESCO. Synimi ynë strategjik është të bëhemi pjesë e BE-së

dhe NATO-s dhe Francën e shohim si partnere në këtë rrugëtim", ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se Kosova është mirënjohëse për kontributin e dhënë ndër vite nga Franca, e cila është e përkushtuar ta çojë përpara partneritetin politik, ekonomik dhe diplomatik. Gjatë takimit kryeministri Haradinaj e ka njoftuar sekretaren Darrieussecq për të

arriturat e Kosovës në forcimin e sundimit të ligjit, për proceset që po kalon vendi ynë, në veçanti për tranzicionin e FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës.

Më pas sekretarja e Shtetit pranë ministrit të Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, me ceremoni ushtarake është pritur edhe nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rustem Berisha, ku kanë biseduar për bashkëpunimin e dyanshëm në mes të Kosovës dhe Francës. Ministri Berisha e ka falënderuar ministrin Darrieussecq për bashkëpunimin dhe për ndihmën që Franca ka dhënë dhe po jep për Kosovën, duke e njoftuar mbi zhvillimet e përgjithshme në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me theks të veçantë për integrimin e gjinisë femërore dhe të komunitetit joshumicë në FSK, si dhe për gatishmërinë e FSK-së që të kontribuojë për paqen dhe sigurinë kudo që ka nevojë, në mënyrë që Kosova të jetë kontribuuese e paqes dhe sigurisë.

Po ashtu, Berisha ka shprehur interesimin për akademitë dhe shkollat ushtarake franceze, me

qëllim të shkollimit dhe trajnimit të oficerëve dhe ushtarëve tanë atje. Ai ka shprehur dëshirën për arritjen e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në të cilin do të konkretizoheshin aktivitetet e përbashkëta.

Kurse ministrja e Francës, Genevieve Darrieussecq, ka përgëzuar ministrin Berisha dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së. "Rajoni i Ballkanit vazhdon të jetë i rëndësishëm për Francën dhe në vazhdimësi jemi krenarë që kemi kontribuar për vendin tuaj. Franca është e kënaqur me të arriturat e vendit tuaj për të ecur përpara. Bashkëpunimi ndërmjet nesh do të vazhdojë të shtohet në të ardhmen. Atasheu ushtarak i sapoakredituar për Kosovën do të jetë urë lidhëse ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Francës dhe Ministrisë së FSK-së", është shprehur Darrieussecq. Të dy ministrat janë zotuar për shtimin e bashkëpunimit dhe mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në të gjitha fushat me interes për të dy vendet.



## Zeqir Bekolli i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Lëvizjes Vetëvendosje të premteniu bashkua Zeqir Bekolli, publicist e shkrim-

tar, gazetar e reporter i luftës, autor i disa veprave letrare dhe publikimeve të ndryshme. "Me prejardhje

nga Korrotica e Epërme e Drenicës, z. Bekolli është veprimtar i përkushtuar për shoqëri, kulturë dhe komb",

ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.





Flet për "Epokën e re", Ragmi Mustafa

# Serbia, përveç njohjes së shteti



Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka thënë se bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund të zgjasin deri në pafundësi. Ai ka bërë me dije se ka ardhur koha që dialogu të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka deklaruar se Serbia nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së shtetit të Kosovës. Ai ka treguar se gjendja në Luginën e Preshevës nuk ka ndryshuar meqë nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve. Mustafa ka thënë se shqiptarët janë në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë

**EPOKA E RE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, të premten u ka bërë thirrje Kosovës dhe Shqipërisë të përkujdesen më shumë për shqiptarët e Luginës së Preshevës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginë. "Shqiptarët janë ende në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë. Një problem tjetër është shkalla e zhvillimit ekonomik e cila është mbase më e ulëta në Ballkanin Perëndimor. Për këtë një numër

i madh i të rinjve po migrojnë drejt Kosovës, Shqipërisë si dhe vendeve të Evropës. Ky është projekt i Serbisë që po zbatohet për të krijuar pasiguri te shqiptarët dhe për t'i përndjekur ata me metodat më të moderuara drejt vendeve të treta në mënyrë që ky vend t'u mbetet serbëve pa ushtrimin e një lufte të armatosur. Fatkeqësisht, Lugina ka një kujdes minimal të Qeverisë së Shqipërisë dhe ende më minimal një kujdes të Qeverisë së Kosovës", është shprehur Mustafa. Sipas tij, Kosova dhe Shqipëria duhet të angazhohen që shqiptarët në Serbi t'i kenë të drejtat e barabarta me serbët në Kosovë. "Kosova dhe Shqipëria kanë mundur ta ndihmojnë Luginën e Preshevës në fushën e arsimit, të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë, përveç nga 50 mijë euro që i patën

dhënë për ngritjen e maternitetit, nuk ka pasur ndihmë tjetër. Ne jemi shumë falënderues edhe për këtë ndihmë, por kemi nevojë që ndihma dhe kujdesi të vazhdojnë. Lugina ka nevojë për projekte që mundësojnë hapjen e vendeve të punës, sidomos në zhvillimin e bujqësisë dhe tregtisë. Këto janë të domosdoshme për t'i mbajtur gjallë shqiptarët në Luginë", ka theksuar Mustafa. Ai ka thënë se bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë për një marrëveshje historike nuk mund të zgjasin deri në pafundësi. Sipas Mustafës, ka ardhur koha që dialogu të përfundojë me njohjen reciproke në mes të dy vendeve. Ai ka deklaruar se Serbia nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së shtetit të Kosovës. "Përfundimisht Serbia nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së shtetit të Kosovës. Çdo zgjidhje



# it të Kosovës, s'ka rrugë tjetër

tjetër nuk do të ishte e frytshme dhe nuk do të ofronte stabilitet në rajon, por do të hapte një perspektivë të shëndoshë për t'i vazhduar diskutimet për pakicat kombëtare në të dy shtetet fqinjë", ka deklaruar Mustafa.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, si është gjendja në Luginën e Preshevës, ka përparim në avancimin e të drejtave të shqiptarëve?

**Mustafa:** Gjendja nuk ka ndryshuar sepse nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Pavarësisht prej miratimit të një shtatëpikëshi që kishte dhënë Qeveria në vitin 2013, për të cilin Vuçiqi e Daçiçi prematuan se do të jetë lehtë i realizueshëm, nuk ka asnjë lëvizje. Shqiptarët janë ende në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë. Një problem tjetër është shkalla e zhvillimit ekonomik e cila është mbase më e ulëta në Ballkanin Perëndimor. Për këtë një numër i madh i të rinjve po migrojnë drejt Kosovës, Shqipërisë si dhe vendeve të Evropës. Ky është projekt i Serbisë që po zbatohet për të krijuar pasiguri të shqiptarët dhe për t'i përndjekur ata me metodat më të moderuar drejt vendeve të treta në mënyrë që ky vend t'u mbetet serbëve pa ushtrimin e një lufte të armatosur. Fatkeqësisht, Lugina ka një kujdes minimal të Qeverisë së Shqipërisë dhe më minimal një kujdes të Qeverisë së Kosovës.

**"Epoka e re":** Nëse vazhdohet me këtë trend të migrimit, a ka

Kosova dhe Shqipëria ish dashur të interesohen për shqiptarët në Luginë të Preshevës sikurse që kujdeset Serbia për serbët në Kosovë. Shqiptarët në Serbi duhet ta kenë tretmanin e njëjtë sikur serbët në Kosovë. Kosova dhe Shqipëria kanë mundur ta ndihmojnë Luginën e Preshevës në fushën e arsimit, të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë, përveç nga 50 mijë euro që i patën dhënë për ngritjen e maternitetit, nuk ka pasur ndihmë tjetër.

rrezik për zbrazjen e Luginës?

**Mustafa:** Nuk do shumë mend të vihet deri te ky konstatim dhe shembullin më të freskët e kemi atë të Medvegjës, ku deri në përfundim të luftës në Kosovë kanë qenë mbi tre mijë shqiptarë, kurse sot nuk kanë mbetur më shumë se 300-400. Por, përderisa kemi 50-60 mijë shqiptarë në Preshevë dhe Bujanoc, Serbia do ta ketë të vështirë ta realizojë këtë projekt të nisur dhe të zbatuar ku për çdo vit arrin ta shpërngulë një Medvegjë të tërë. Në krejt këtë situatë Kosova dhe Shqipëria bëhen sikur nuk shohin dhe nuk dëgjojnë, madje sikur mos të ekzistojë Lugina. Vetëm për ndonjë marketing politik në kohë të fushatës zgjedhore u intereson Lugina sa për t'i marrë votat e shqiptarëve të kësaj pjese që tani jeton në Kosovë apo në Shqipëri.

**"Epoka e re":** Pse po mungon përkrahja e Kosovës dhe Shqipërisë për Luginën e Preshevës?

**Mustafa:** Kosova dhe Shqipëria ish dashur të interesohen për shqiptarët në Luginë të Preshevës sikurse që kujdeset Serbia për serbët në Kosovë. Shqiptarët në Serbi duhet ta kenë tretmanin e njëjtë sikur serbët në Kosovë. Kosova dhe

Shqipëria kanë mundur ta ndihmojnë Luginën e Preshevës në fushën e arsimit, të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë, përveç nga 50 mijë euro që i patën dhënë për ngritjen e maternitetit, nuk ka pasur ndihmë tjetër. Ne jemi shumë falënderues edhe për këtë ndihmë, por kemi nevojë që ndihma dhe kujdesi të vazhdojnë. Lugina ka nevojë për projekte që mundësojnë hapjen e vendeve të punës, sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe tregtisë. Këto janë të domosdoshme për t'i mbajtur gjallë shqiptarët në Luginë. Po ashtu, Kosova e Shqipëria duhet ta ngritin zërin në institucionet ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës.

**"Epoka e re":** Si e shihni fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi? Prisni efekte pozitive nga ky proces?

**Mustafa:** Me të drejtë mund të quhet fazë përmbyllëse, sepse kanë kaluar pesë vjet të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet për një marrëveshje historike ndërmjet dy vendeve nuk mund të zgjasin deri në pafundësi. Edhe këto pesë vjet kanë qenë të tepërta sepse ka pasur mundësi që çështjet e diskutuara të zgjidhen shumë më shpejt. Kosova është shtet i

pavarur dhe kjo është e padiskutueshme. Kosova e pavarur është një pikë e vendosur e cila nuk bën të lëvizet kurrë. Tanimë është e njohur prej më shumë se 110 shteteve në botë. Përpjekjet e presidentit Vuçiq janë demagogji të kulluara, dhe ai duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës.

**"Epoka e re":** Besoni se ky dialog do të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve?

**Mustafa:** Përfundimisht Serbia nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së shtetit të Kosovës. Çdo zgjidhje tjetër nuk do të ishte e frytshme dhe nuk do të ofronte stabilitet në rajon, por do të hapte një perspektivë të shëndoshë për t'i vazhduar diskutimet për pakicat kombëtare në të dy shtetet fqinjë. Pasi që Serbia ta njohë Kosovën mund të hapen bisedime për realizimin e të drejtave të serbëve në Kosovë duke kushtëzuar ato me të drejtat e shqiptarëve në Serbi. Kjo është zgjidhja definitive. Ka ardhur koha që Serbia ta njohë Republikën e Kosovës me këta kufij që i ka, me të cilët është njohur nga ShBA-ja dhe vendet e tjera të fuqishme të Evropës. Kosova duhet ta shtojë angazhimin për zbatimin e plotë të marrëveshjeve që janë arritur deri më tani në Bruksel. Serbia nuk po i zbaton marrëveshjet që janë arritur në fushën e të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës siç ishte rasti i marrëveshjes për njohjen reciproke të diplomave. Deri më tani asnjë diplomë nuk është njohur. Derisa Serbia kërkon realizimin e plotë të marrëveshjeve të arritura, nga ana tjetër Kosova fare nuk i përmend.

## Ministri Hasani u bënë thirrje qytetarëve të Shqipërisë ta vizitojnë Kosovën

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka pritur të premten në takim kryetarin e Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli. Ata kanë bërë thirrje që turistët nga Kosova t'i vizitojnë plazhet e Vlorës, kurse turistët nga Shqipëria t'i vizitojnë bukuritë natyrore të Kosovës.

Gjatë këtij takimi ministri Hasani ka kërkuar nga kryebashkiaku Leli të organizohen vizita të nxënësve nga Vlora në Kosovë. Hasani ka

thënë se jo vetëm Vlora, por edhe qytetet e tjera të Shqipërisë duhet të organizojnë vizita të nxënësve në Kosovë, në mënyrë që ta ndihmojnë turizmin e Kosovës. "Ishte edhe një ide që nxënësit nga Vlora ta vizitojnë Kosovën", është shprehur Hasani. Kurse kryetari i Bashkisë së Vlorës, Dritan Leli, është shprehur shumë i kënaqur me pritjen që i është bërë, duke thënë se këtu ka gjetur një partneritet që gjithsecili do ta dëshironte.





## Kërkohet përkujdesje më e madhe për fëmijët

Me aktivitete të ndryshme është shënuar të premten në Kosovë 1 Qershori - Dita e Ndërkombëtare e Fëmijëve. Rreth 400 fëmijë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga e gjithë Kosova kanë vizituar Kuvendin e Kosovës, kurse përfaqësuesit e institucioneve janë zotuar se do të krijojnë kushte dhe mjedis më të mirë për fëmijët



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Me rastin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, rreth 400 fëmijë, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga e gjithë Kosova, kanë vizituar të premten Kuvendin e Republikës së Kosovës. Fëmijët janë pritur në zyrën e tij nga kryetari Kadri Veseli dhe deputetë të tjerë të Kuvendit. Gjatë qëndrimit në mjediset e legjislativit ata janë njohur nga afër me punën dhe mënyrën e organizimit të institucionit më të lartë ligjvënës dhe përfaqësues të Kosovës. Po ashtu, nxënësit kanë ndjekur edhe një pjesë të seancës plenare. Me këtë rast, kryeparlamentari Veseli ka përshëndetur fëmijët dhe i ka uruar ata për

ditën e tyre. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ka thënë se investimi në fëmijë është investim në të ardhmen. "Fëmijët çdo ditë e bëjnë jetën tonë më të mirë, prandaj edhe ne duhet të bëjmë më shumë për t'u siguruar një mjedis më të mirë atyre", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në ambientet e Qeverisë së Kosovës ka pritur në takim një grup fëmijësh në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se detyrë e tyre është t'i mbrojnë fëmijët nga çdo lloj abuzimi. "Fëmijët janë motivi i të gjitha përpjekjeve tona jetësore. Realizimi i ëndrrave dhe

shpresave të tyre është suksesi suprem i yni si shoqëri e shtet. Detyrë jonë e përbashkët është të sigurojmë që ata të jenë të edukuar mirë, të lirë e të sigurt dhe t'i mbrojmë nga çdo lloj abuzimi e dhune", ka thënë kryeministri Haradinaj. Edhe zëvendëskryeministri dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka uruar për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, duke thënë se ata janë e ardhmja

e çdo shoqërie. Ai ka theksuar se bartësit e institucioneve e kanë për obligim që fëmijëve në Kosovë t'u krijojnë kushte sa më të mira për shkollim, edukim si dhe mundësi për t'i realizuar ëndrrat dhe dëshirat e tyre. Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF, me rastin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ka adresuar rekomandimet kryesore të dala nga Indeksi i Mbrojtjes së

Fëmijës për fushat më kritike të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. "Tashmë Kosova duhet ta zbatojë legjislacionin dhe t'i sigurojë burimet adekuate përmes së cilave do ta fuqizojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Kosova duhet të bëjë investime financiare për t'i ndërtuar kapacitetet që do ta mbyllnin hendekun midis legjislacionit dhe zbatimit të tij", thuhet në njoftim.

## Klinika e Neonatologjisë bëhet me ultrazë për ekzaminim të foshnjave

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Klinika e Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) nga dita e premte do të ketë një aparat ultra sonografi (ultrazë), i cili do ta lehtësojë diagnostifikimin e foshnjave të porsalindura.

Ultrazëri është donacion nga Banka Raiffeisen dhe Aksioni për Nëna dhe Fëmijë.

Me rastin e pranimit të këtij donacioni, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka falënderuar donatorët, duke shtuar se ky donacion është i mirëseardhur për Klinikën e Neonatologjisë. Ai ka pohuar se Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim edhe me Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, është duke punuar intensivisht të bëhen përmirësime të vazhdueshme në sektorin shëndetësor. Ministri Ismaili ka theksuar se në



QKUK gjatë këtij viti do të blihen aparatura dhe do të ketë përmirësime në infrastrukturë, që do ta lehtësojnë punën e stafit

shëndetësor, i cili, edhe pse në kushte të vështira, po jep kontribut të madh.

Drejtori i Raiffeisen Bank për

Kosovë, Robert Wright, ka theksuar se në fokus të bankës janë edhe ndihmesat dhe donacionet në fusha të ndryshme. Ai ka

potencuar se në fillim kanë qenë të fokusuar në investimet në fushën e sportit dhe kulturës, përderisa tani më shumë do ta përkrahin shëndetësinë.

Ndërkaq drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm këtë donacion, duke theksuar se përmes tij do të bëhet më i lehtë diagnostifikimi i patologjive të ndryshme tek foshnjat e porsalindura.

Përfaqësuesja e Aksionit për Nëna dhe Fëmijë ka thënë se përmes këtij donacioni po përmbyshet një prej qëllimeve që ka Aksioni për Nëna dhe Fëmijë: përmirësimi i shëndetit të nënave dhe foshnjave.

Për rëndësinë dhe lehtësimin që do të bëhet përmes punës me këtë ultrazë ka folur edhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të Klinikës së Neonatologjisë, dr. Xhevdet Gojnovci.

## Përfundon pjesa e parë e testit të maturës në të gjitha rajonet

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Maturantët e rajonit të Pejës dhe të Mitrovicës kanë qenë të fundit që i janë nënshtruar testit të maturës shtetërore 2018 (pjesa e parë e afatit të parë), i cili këtë vit për herë të parë është mbajtur përgjatë katër ditëve në

gjithë Kosovën. Në ditën e fundit, pra në rajonin e Pejës dhe të Mitrovicës, sipas raporteve nga terreni, procesi i testimit ka shkuar shumë mirë dhe sipas planifikimit. Ndërsa gjatë kësaj dite numri i nxënësve që u janë gjetur celularë ka qenë

shumë i vogël. Gjatë katër ditëve të pjesës së parë të Testit të Maturës nuk është evidentuar ndonjë parregullsi që do ta bënte testin të pavlershëm.

Pjesa e dytë e afatit të parë do të mbahet më 5, 6, 7 dhe 8 qershor.





Në vjeshtë do të përfundojë procesi zgjedhor në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK)

## Veseli: Është koha që PDK-ja të ndryshojë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se partia që drejton nuk do të largohet asnjëherë nga vlerat e saj, por do të punojë gjithmonë për të ndryshuar aty ku duhet, vetën dhe Kosovën. Në një konferencë për medie, në të cilën ka folur për procesin zgjedhor në Rininë Demokratike, ai ka thënë se PDK-ja është partia me besimin më të madh qytetar. "Është koha që edhe PDK-ja të ndryshojë. Të hapët edhe më shumë për çdo individ, çdo profesion, për ata që angazhimin politik e shohin si mision për vendin e jo për veten", ka Veseli

**EPOKA E RE** Faton DERMAKU

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të premten ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka diskutuar për procesin zgjedhor që po zhvillohet aktualisht në Rininë Demokratike të Kosovës, proceset e brendshme në PDK si dhe vizionin e Dekadës së Re. "Vizioni i Dekadës së Re po shtrihet gjithandej Kosovës. Falënderoj mbi 20 mijë të rinj, vajza dhe djem, që deri më tani kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor të nëndegëve të Rinisë Demokratike në çdo komunë të Kosovës. Unë kam ndjekur nga afër shumë kuvende zgjedhore dhe, si asnjëherë më parë, ka pasur një angazhim entuziast e të sinqertë për t'i ndërtuar strukturat e reja rinore", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se ky angazhim i të rinjve, të edukuar, të përgjegjshëm dhe që e duan shtetin e tyre të ecë përpara, është shpirti i Dekadës së Re, është filozofia e shtetit të Kosovës.

Veseli ka shtuar se pas dy dekadave, asaj të lirisë dhe të pavarësisë, kjo dekadë në të cilën kemi hyrë i takon gjeneratës që punon për një transformim ekonomik për vendin, për edukim më cilësor, për shëndetësi të dinjitetshme, për një jetë evropiane ashtu siç e meritojmë. Ai ka bërë me dije se procesi zgjedhor i Rinisë Demokratike do të përfundojë në fund të qershorit. "Përfundimi i procesit zgjedhor nëpër nëndegët e rinisë të Partisë



Demokratike të Kosovës, u hapë rrugë zgjedhjeve rinore nëpër degë. Ky proces do të fillojë nga nesër, në rreth 100 degë, për të përfunduar në fund të qershorit në Konventën Rinore. Rinia ka qenë shtyllë e vendit, bartëse e proceseve më të mëdha, lirisë dhe pavarësisë", ka theksuar Veseli, duke shtuar se Kosova është vend i rinisë. "PDK-ja ka qenë gjithmonë parti e të rinjve", është shprehur Veseli, i cili ka shtuar se PDK-ja është partia me

besimin më të madh qytetar. "Qytetarët kanë besuar dhe besojnë se është PDK-ja, filozofia e saj politike, që ndryshon gjendjen në çdo sektor. Dhe ne e ndiejmë shumë këtë peshë të besimit. Duke e ndier këtë, ne e dimë se është koha që edhe PDK-ja të ndryshojë. Të hapët edhe më shumë për çdo individ, çdo profesion, për ata që angazhimin politik e shohin si mision për vendin e jo për vetën e tyre", ka potencuar Veseli. Ai ka shtuar se

PDK-ja nuk do të largohet asnjëherë nga vlerat e saj, por do të punojë gjithmonë për të ndryshuar aty ku duhet, veten dhe Kosovën. "Në këtë frymë, pas përfundimit të procesit zgjedhor për rininë, ne do të hyjmë gradualisht në procesin zgjedhor për strukturat drejtuese të PDK-së në nivel vendi, proces ky që do të përfundojë në vjeshtë. Si bartës i këtij procesi, dëshiroj të theksoj përkushtimin dhe vendosmërinë e secilit anëtar për një proces

shumë transparent, një proces të ballafaqimit të ideve e planeve për vendin, në frymën e bashkëpunimit dhe dëshirës për ta zhvilluar edhe më shumë Kosovën", ka deklaruar Veseli. Gjatë kësaj konference për medie, Veseli u përgjigj në disa pyetje të gazetarëve lidhur me liberalizimin e vizave, platformën e përbashkët nacionale dhe lobimin në vendet e tjera rreth liberalizimit të vizave të paralizuar ditë më parë.

## Hoxha nënshkruan marrëveshje 48 milionë euro me Komisionin Evropian



BRUKSEL, 1 QERSHOR - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, bashkë me drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit, Genoveva Ruiz Calavera, në mjediset e Komisionit Evropian në Bruksel, ka nënshkruar të premten marrëveshjen financiare IPA 2017. Kjo marrëveshje, pjesa e parë, ka vlerë prej 49.4 milionë eurosh. Nga kjo vlerë 48 milionë euro do të financohen nga Bashkimi Evropian, kurse 1.4 milion euro janë bashkëfi-

nancim i Qeverisë së Kosovës. Me këtë marrëveshje Kosova do të përfitojë asistencë financiare të cilën do ta përdorë për avancimin e demokracisë dhe qeverisjen, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe të drejtat e njeriut, mbrojtjen e mjedisit, projektet për klimën dhe energjinë, rritjen e konkurrencës dhe inovacionit, bujqësisë dhe zhvillimit rural. Po ashtu, këto fonde do të përdoren për avancimin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale. Kosova tash e sa vite është përfituese e fondeve të IPA-s

dhe neve na mbetet ta shfrytëzojmë këtë asistencë për implementimin e reformave dhe të gjitha projektet duhet të rezultojnë me përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë. Në përputhje me dinamikat nëpër të cilat është duke kaluar Kosova në rrugën e saj drejt BE-së, Ministria e Integritimit Evropian, në bashkëpunim me të gjithë dikasteret shtetërore, do ta risë përkushtimin e saj për mbarëvajtjen e kësaj asistencë financiare, në mënyrë që efektet e kësaj asistencë të ndihen te secili qytetar i Kosovës.



# ATK-ja mbledh 193.5 milionë euro nga janari deri në maj

**EPOKA E RE**

Arbisa SHEFKIU


PRISHTINË, 1 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se performanca e të hyrave tatimore është me trendë pozitivë. Sipas këtij institucioni, ka rritje të vazhdueshme në të gjithë muajt e vitit si në raport me planin, po ashtu edhe në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. "Përkushtimi i menaxhmentit të ATK-së për zbatimin e planeve operative dhe planeve të trajtimit të rrezikut të hartuara për këtë vit janë në linjë të plotë me Strategjinë 2015-2020, si dhe synimet e Qeverisë për ngritjen e përmbushjes tatimore", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës vetëm nga muaji janar deri në maj të këtij viti nga të hyrat e rregullta ka mbledhur 193.5 milionë euro. "Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kalu-

ar kemi rritje për 26.1 milionë euro apo 15.6 %, ndërsa në raport me planin janë mbledhur 13.3 milionë euro apo 7.4 % më shumë të hyra se plani i paraparë. Po gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar mbi 65.1 milionë euro të hyra për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

ATK-ja me kapacitetet e saj dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit është e përgatitur t'i zbatojë të gjitha iniciativat e Qeverisë në funksion të lehtësimit për të bërit biznes në Kosovë. "Jemi të përkushtuar të punojmë me përfaqësuesit e bizneseve, që t'o mbështesim të gjitha përpjekjet për një zhvillim sa më të madh ekonomik dhe konkurrencë të ndershme në treg", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Në këtë njoftim theksohet se prioriteti i ATK-së është luftimi i informalitetit në Kosovë, posaçë-



isht në pjesën e ekonomisë së hirtë, ku përgjegjësia e ATK-së është e përcaktuar me ligj. "Inkurajues është fakti se përmbushja vullnetare është në nivel të

kënaqshëm, marrë parasysh edhe vizitat në terren të cilat realizohen, e të cilat nuk kanë karakter vetëm përmbushës, por edhe edukativ (edukimi i tatimpaguesve në

kryerjen me kohë të obligimeve tatimore, në mënyrë që mos të bëhen preh e ndëshkimeve administrative)", është thënë në njoftimin e ATK-së.



## Hapet Qendra për Edukim Mjedisor në pyllin e arinjve

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, mori pjesë të premtën në ceremoninë e hapjes së Qendrës për Edukim Mjedisor në pyllin e arinjve në Prishtinë. Para të pranishmëve të shumtë, ambasadorë, zyrtarë shtetërorë

e figura të tjera të njohura, ministrja Reshitaj ka thënë se kjo qendër është rezultat i një pune të mirë që është bërë, së cilës i ka paraprirë ndërtimi i strehimores "Pylli i Arinjve" si një storie suksesi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fondacionit "Four Paës" dhe

aktorëve të tjerë që kanë përkrahur këtë projekt. "Qendra për Edukim Mjedisor është një mundësi e mirë për të gjithë vizitorët, në veçanti për brezat e ardhshme të Republikës së Kosovës, për t'u informuar lidhur me rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe të natyrës", ka

vlerësuar ministrja Reshitaj. Ai ka shtuar se në kuadër të përpjekjeve të ministrisë që ajo drejton, për ta ruajtur florën dhe faunën në Kosovë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin si një dokument themelor për mbrojtjen e

natyrës i cili përcakton objektivat afatgjata dhe afatmesme për ruajtjen e biodiversitetit. Ministrja Reshitaj ka theksuar se do të angazhohet në hapjen e qendrave të tilla edhe në komunat e tjera si formë e qëlluar e promovimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor.



# Gërzhaliu: Kosova urgjentisht duhet të aplikojë për anëtarësim në OBT

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërzhaliu, ka bërë me dije se Kosova duhet të aplikojë urgjentisht për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). "Është momenti i fundit kur Kosova duhet seriozisht ta shqyrtojë aplikimin në OBT. Prej vendeve të rajonit, Kosova është i vetmi shtet që nuk është pjesë e kësaj organizate, madje as si vëzhgues", ka thënë Gërzhaliu



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërzhaliu, ka apeluar që Kosova urgjentisht të aplikojë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), e cila aktualisht ka selinë në Gjenevë të Zvicrës. Ai ka thënë se tregtia ndërkombëtare ndërmjet vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës zhvillohet në kuadrin e veprimtarisë së shumë strukturave ndërqeveritare, të cilat po luajnë një rol gjithmonë e më të madh për vendosjen e normave dhe rregullave të tregtisë së mallrave dhe të shërbimeve.

Megjithatë, sipas tij, OBT-ja me seli në Gjenevë të Zvicrës është e vetmja që ka në strukturën e saj pothuajse të gjitha shtetet e botës, përfaqësuesit e të cilave

zhvillojnë diskutime dhe përfaqësojnë interesat e shteteve të tyre respektive për çështje të tregtisë, duke filluar nga tarifrat dhe barrierat jotarifore e deri te shqyrtimi i politikave tregtare të vendeve anëtare të OBT-së. "Por, Kosova, pavarësisht prej faktit se bisedimet dhe takimet me Organizatën Botërore të Tregtisë kanë nisur shumë kohë më parë, vazhdon të mbetet larg këtij institucioni për shkak të mosparaqitjes së një kërkesë formale për anëtarësim në këtë organizatë", ka thënë Gërzhaliu, duke shtuar se, sipas mbarëvajtjes së këtij procesi, deri më tani çështja e paraqitjes së kërkesës zyrtare për anëtarësim në sekretariatit e OBT-së është tërësisht politike, pavarësisht prej përgatitjeve teknike që janë bërë në drejtim të anëtarësimit. "Shikuar nga një prizëm më i gjerë, Kosova nga ky anëtarësim,

fillimisht si vëzhguese, më shumë do të fitojë politikisht sesa ekonomikisht. Megjithatë, prania e përfaqësuesit të Kosovës në takimet dhe diskutimet rreth tregtisë botërore në OBT ka rolin e saj kyç në përgatitje të vendit tonë për anëtarësim të plotë në këtë organizatë që rrjedhë natyrisht pas statusit të vëzhguesit dhe përafrim të legjislacionit konform rregullave të OBT-së", ka theksuar kreu i OEK-ut.

Gërzhaliu ka shtuar se negociatat për anëtarësim, sipas përvojave të vendeve të tjera, kanë zgjatur 5 deri në 15 vjet. "Andaj është momenti i fundit kur Kosova duhet seriozisht ta shqyrtojë aplikimin në OBT. Prej vendeve të rajonit, Kosova është i vetmi shtet që nuk është pjesë e kësaj organizate, madje as si vëzhgues. Nga dimensionit rajonal, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia janë shtetet e fundit që

janë duke synuar anëtarësim, statusi aktual i të cilave është si vëzhgues në OBT", ka thënë Gërzhaliu. Ai ka theksuar se Oda Ekonomike e Kosovës ka rekomanduar aplikim urgjent për anëtarësim në këtë organizatë me rëndësi multidimensionale edhe si vëzhgues në të njëjtin model siç kanë aplikuar vendet e rajonit dhe që ky proces të mos jetë i ndikuar nga dimensionit i politikës së brendshme.

## Komuna e Skenderajt do t'i shfrytëzojë shërbimet e Telekomit të Kosovës



PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Punonjësit e Komunës së Skenderajt tash e tutje do t'i shfrytëzojnë shërbimet e Telekomit të Kosovës. Nënshkrimin e kësaj kontrate e kanë bërë të premtën ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Zeqir Kiqina, dhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Nënshkrimi i kësaj kontrate do ta lehtësojë komunikimin e tërë personelit të Komunës së Skenderajt, punëtorëve arsimorë, shëndetësorë dhe të gjithë punonjësve të sektorit publik,

përmes pakove të reja PostPaid dhe PrePaid, ndërsa Telekomit të Kosovës do t'i sjellë në total afër 1200 konsumatorë të rinj. "Komuna e Skenderajt rikthen besimin në Telekomin e Kosovës, Vala dhe nga tani e tutje të gjithë punonjësit e kësaj komune do t'i shfrytëzojnë shërbimet e operatorit tonë. Ndiem jashtëzakonisht i nderuar që me kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, sot lidhëm kontratë për ofrimin e shërbimeve të Telekomit të Kosovës, Vala, njëherësh u pajtuam të kemi bashkëpunim reci-

prok për realizimin e suksesshëm të projekteve tona, që për qëllim kanë ofrimin e shërbimeve cilësore", ka thënë ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Zeqir Kiqina. Ai ka theksuar se Telekomit të Kosovës, Vala, edhe në të ardhmen do ta vazhdojë përmbushjen e synimeve strategjike, duke u mundësuar qytetarëve, institucioneve publike dhe shtetërore si dhe bizneseve e ndërmarrjeve private, t'i shfrytëzojnë produktet dhe shërbimet me pako sa më të favorshme.

## Ujësjetësi në muajin maj ka shkyçur 174 konsumatorë borxhlinj

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Kompania e Ujësjetësi Rajonal "Prishtina" ka njoftuar të gjithë konsumatorët se aksioni për shkyçjen individuale të konsumatorëve borxhlinj nga shërbimet e ujësjetësit dhe kanalizimit është duke vazhduar me intensitet të lartë në qytete e fshatra, me theks të veçantë në

Prishtinë. Me shkyçje po përballet secili konsumator që ka dy e më shumë fatura të papaguara ndaj shërbimeve të ujësjetësit dhe kanalizimit. "Vetëm në muajin maj 2018 janë realizuar 174 shkyçje individuale, ku 11 prej tyre janë shkyçur për shkak të zbulimit të kyçjeve ilegale të tyre nga ana e

inspektorëve tanë, 163 janë shkyçje individuale për shkak të mospagesave të shërbimeve të ujësjetësit dhe kanalizimit, ndërsa nga gjithsej 174 shkyçje, 54 prej tyre janë rikyçur, pasi që kanë paguar obligimet e tyre ndaj shërbimeve tona", është thënë në njoftimin e kompanisë Ujësjetësi Rajonal "Prishtina".





# Faik e Besim Ukëhaxhaj, rënia dhe përkujtimi

## Shkëlzen UKËHAXHAJ

Sot është 2 qershori. Këtë mund ta dinë të gjithë njerëzit e kësaj bote, por mund të mos e dinë ata që s'kanë të bëjnë asgjë me këtë datë, ose nuk i lidh asgjë me këtë datë. Pra, ata janë indiferentë dhe jeta e tyre vazhdon si rrjedha e një lumi të qetë e i patrazuar.

2 qershori ka një kuptim, për ata njerëz që ua kujton qershorin e vitit 1998, tanimë të largët. Janë ato ditë të fundmajit dhe fillimit të qershorit, ku në Deçan, Carrabreg e rrethinë u zhvilluan luftime të ashpra midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë serbe në ofensivën e asaj vere.

Kishite kohë që në Carrabreg ishte pozicionuar UÇK-ja dhe për ushtrinë serbe ajo rrugë ishte bërë e pakalueshme. Carrabregu, një fshat buzë qytezës së Deçanit, shtrihet në të dy krahët e rrugës magjistrale për në Gjakovë. Andaj për të shkuar në Gjakovë e fshatrat përreth, ushtrisë serbe i duhej për ta asgjësuar fortesën e UÇK- së në këtë fshat "rebel". Ushtria serbe kishte vendosur ta shpërthente fortesën e UÇK-së, në anën tjetër edhe UÇK-ja ishte e vendosur për të mos bërë asnjë hap prapa. Ajo, ushtria serbe, do të përdorte gjithë armatimin e saj në dispozicion, nga armët e lehta e deri tek ato të sofistikuarat, duke mos kursyer as ato fluturueset, helikopterët.

Në anën tjetër djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me armët më të lehta të kohës, si kalorësit e dikurshëm të Skënderbeut, kishin vendosur për ta bërë vdekjen, por jo t'ia kthenin krahët ushtrisë serbe. Ato ditë kishim edhe humbje të mëdha, kishin rënë dëshmorët djemtë më të mirë, kishim të plagosur lehtë e rëndë. Këtu po nënvizoj, se po ato ditë, në mbrojtje të pikës së UÇK-së në shkollën fillore të Carrabregut, plagoset rëndë vëllai i Faikut dhe natyrisht kushëriri i Besimit, Isuf Ukëhaxhaj, i cili në gjendje të rëndë shëndetësore në spitalin e UÇK-së në Glogjan, pas tri ditësh, merr lajmin e hidhur për rënien edhe të vëllait, Faikut dhe kushëririt, Besimit. Andaj këto ditë, në këtë vit jubilar, për qëndresën e atij viti po bëhen përkujtime në nderim të veprës së tyre. Prandaj, pikërisht për nga numri i të rënëve, cilësisë së luftës së atyre djemve dhe rëndësisë që kishte mbrojtja e asaj "fortese" të UÇK-së. Kjo betejë një ditë do të zë vend në analet e historisë. Edhe pala tjetër kishte humbjet e saj të mëdha, por ne sot jemi në një



ditë përkujtimi për dëshmorët tonë, e kjo punë le t'u mbesë historianëve për ta gjurmuar.

Në momentet e rënies së Faikut dhe Besimit nuk ka pasur dëshmitarë, përveç oshtimave të armëve nga të dyja anët që janë dëgjuar që larg. Dëshmitë që përcaktojnë rënien e tyre heroike janë sasia e gëzhgojave të gjetura dhe të mbledhura nga nëna e Besimit, si dhe trupat e atyre dy kreshnikëve.

Nuk mund ta kapërcejnë 2 qershorin e pa iu kujtuar ajo ditë të gjithë atyre që luftuan dhe ishin bashkë gjatë asaj ofensive të përgjakshme. Ata medoemos e kujtojnë se ishin në vijën midis jetës dhe vdekjes, vdekja nuk ishte më larg se këmisha që mbanin në trup; kujtesa për trimat që, ata kishin njohur, i bën krenarë. Krenarë janë, edhe për atë se ishin pjesë e asaj historie, veç fati ka bërë që ata të jetojnë. Në këtë mënyrë mund t'u përcjellin gjeneratave të reja se në Kosovë ishte zhvilluar luftë për ta ndjekur pushtuesin shekullor. Në saje të asaj lufte, për të cilën duhet të jemi krenarë të gjithë shqiptarët, sepse të gjithë kanë dhënë kontributin e tyre në një mënyrë a tjetër, e kështu sot jetojmë të lirë në shtetin e Kosovës.

Kursesi nuk mund ta kapërcejnë

2 qershorin pa e kujtuar familjarët e të rënëve, Faikut dhe Besimit. Fëmijët e tyre tani janë të rritur, janë të martuar, bile edhe prindër ndonjëri nga ata. Por, njëzet vjetët e kaluara pa praninë e prindit kanë qenë shumë të vështira. Në secilin hap të jetës së tyre iu ka munguar mbështetja e prindit. Iu ka munguar qortimi kur kanë bërë ndonjë gabim dhe këshilla kundrejt qortimit se si ecet më mirë e më lehtë në jetën plot me barriera të kohës në të cilën po jetojmë. U ka munguar mbi të gjitha lëvdata dhe përqafimi atëror, kur kanë marrë notë të mirë në shkollë, sidomos kur kanë marrë ndonjë hap të guximshëm që doemos ka qenë hap prosperitiv për jetën e tyre. Por, në fund ata dhe gjithë bijë e bijat e të gjithë dëshmorëve, tanimë të rritur e të pjekur për jetë, janë të vetëdijshëm se ky është çmimi i lirisë të cilën e jetojnë dhe, për këtë fakt, janë krenarë me etërit e tyre. Ata po, por ne të tjerët, a jemi të vetëdijshëm pas plot 20 vjetësh, se pa luftën dhe rëniet heroike të këtyre kreshnikëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, anekënd trojeve shqiptare, Kosova sot nuk do të ishte e lirë, nuk do të votohej për Kuvendin e Republikës së Kosovës, kryetar e

kryeministër të Kosovës, por për Kuvendin e Republikës së Serbisë...? Ndonëse nënkuptohet përgjigjja, nuk mund të mos nënvizoj që pikërisht ata që gëzojnë postet nëpër institucionet e vendit, të gjithë ata që marrin rrogë nga ky shtet i ri, i lodhur e anemik, duhet t'i vejnë gishtin kokës dhe të jenë të vetëdijshëm se sa e shtrenjtë ishte liria jonë. Për ata që mendojnë se nuk është kështu, çuditërisht, por ka, atëherë unë po mjaftohem t'u them se edhe sot më 2 qershor, pas njëzet vjetësh, Serbia mendon se nuk e ka humbur Kosovën apo ndonjë pjesë të saj.

Ne të gjithë kemi kaluar nëpër shkollë dhe kemi shfletuar shumë faqe librash. Ne kemi parë fotografi dhe kemi lexuar për protagonistë të ngjarjeve historike, kështu është tentuar që truri ynë të fokusohet aty dhe jashtë asaj hapësirë e papërfytyruar. Kjo gjendje psikologjike të lë përshtypjen se kjo është historia dhe pikë. Këta kryepersonazhe, protagonistë, që jemi mësuar t'i përfytyrojmë përmes fotografive të shumta, filmave e dokumentarëve e kanë pasur rëndësinë e tyre e kjo nuk mohohet, për më tepër për një numër të konsiderueshëm, pa ata, historia e Kosovës nuk do të ishte kjo.

Unë dhe shumë të tjerë, të cilët gjykojnë me kokën e tyre, themi jo.

Ka edhe një të vërtetë tjetër dhe lexuesi apo qytetari i këtij vendi duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë. Historinë e vërtetë të Kosovës e kanë bërë njerëz që kanë punuar dhe vepruar çdo ditë të jetës së tyre, deri te rënia me plot nder për Kosovën. Kjo rrugë, e cila ka qenë vërtet e gjatë dhe e mundimshme e me plot sakrificë, e jo vetëm për ata vetë, por për mbarë familjen. Për një numër të konsiderueshëm familjesh kjo rrugë ka qenë jo më e shkurtër se gjysmëshekulli përpjekje e veprimtari me plot sakrificë për këtë vend. Këta nuk janë pak, janë një armatë e tërë. Kjo histori është e fshehur nga mediat, fotografitë dhe dokumentarët. Kush janë dhe cilët janë u takon historianëve të nxjerrin të dhënat nga thellësia e harresës për ta kompletuar historinë tonë të vërtetë. Në këtë mënyrë do t'u shpaguej, sadopak, ai mundi pashpagueshëm. Një përkujtim në datën e rënies, një buqetë me lule dhe përlulje para varrit, dëshmorët nuk e pranojnë për nderim. Njëzet vjet, sot, pas rënies, Kosova nuk është ajo që ata e kanë dëshiruar, andaj ata me heshtjen e tyre e injorojnë këtë nderim. Po të ngrihen dëshmorët dhe të shohin në TV një ditë pune të Kuvendit të Kosovës, ashtu siç e shoh unë dhe mijëra e mijëra qytetarë, kur deputetë nga të gjitha anët dhe krahët politikë ngrihen dhe akuzojnë njëri-tjetrin për milionat e vjedhur nga fondet e mbledhura nga bashkatdhetarët në mërgim për të ndihmuar dhe shpejtuar çlirimin e Kosovës dhe ndërtimin e shtetit pas lufte; kur akuzojnë njëri-tjetrin se janë bërë milionerë dhe multimilionerë në supe të Kosovës; kur ata për të qeverisur për katër vjet bëjnë marrëveshje e konsensus të çuditshme e gjëra të tjera të ulëta, kishin për të rënë në heshtjen e dhimbjes krenare dhe do të shpreheshin me zërin e Pashkë Vasës: Ah Kosovë, e mjera Kosovë!

Që ka vend për të kritikuar për rrugëtimin tonë të gjatë këtyre 20 vjetëve, kjo nuk diskutohet dhe nuk i vihet asnjë pikëpyetje. Kosova nuk e ka identitetin autoritativ të një shteti para bashkësisë ndërkombëtare. Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi nuk punojnë plotësisht me kokën e tyre, dirigjohen si orkestra nga dirigjenti. Gjatë rrugës së këtyre 20 vjetëve kanë ndodhur gabime, për këtë jemi të vetëdijshëm. Përkundër kësaj politikanë dhe "diplomatë" tanë kanë bërë edhe libra të vëllimshëm për të argumentuar



atë mal me "suksese" në këta 20 vjet shtet dhe dhjetë vjet pavarësi. Ky mal "suksesesh" nuk mbulon dot ata grumbuj me plot gabime domethënëse dhe esenciale për Kosovën, e kjo para dëshmorëve, e sot pikërisht, para Faikut dhe Besimit, na bënë të ulim kokën. Por qëllimi ynë, sot, nuk është të kritikojmë, por të përkujtojmë.

Pra, sot, më 2 qershor, për çdo vit, ne kujtojmë rënien e Besimit dhe Faikut. Përkujtojmë me pietet jetën e tyre të shkurtër, shumë të shkurtër, dhe rënien e tyre heroike për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb. Rënia e tyre hapi rrugën e perspektivës të fëmijëve tanë në Kosovën e pashpresë të atyre ditëve. Unë, autori i këtyre rreshtave, kujtoj Faikun dhe Besimin që nga rinia e tyre e hershme, e kujtoj shpirtin e tyre luftëtar. Edhe pse ishin rritur dhe zhvilluar bashkë, valët e jetës i kishin drejtuar rrugëve të ndryshme. Përderisa Besimi pas dy vjetësh gjimnaz kishte vendosur ta merrte drejtimin dhe shkollimin për hoteleri dhe turizëm, Faiku, ndërkohë, pas gjimnazit kishte ëndërruar për të studiuar. Rruga e thellimit të dijes për Faikun ishte ndërprerë në vitin e tretë të gjimnazit më 1982. Ai kishte organizuar një grup shokësh, emrat e të cilëve në këtë rast më duhet t'i lë anash, për të bërë një demonstratë në Deçan, për t'i përkujtuar demonstratat e vitit 1981, me ç'rast ishin burgosur një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe profesorëve të Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri". Pas marrjes në pyetje të hetuesi, disa shokë të Faikut mbahen në burg, e natyrisht edhe ai si iniciues dhe organizues. Si rrjedhojë e kësaj, pas burgut, atij iu kishin mbyllur dyert e Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri", pra ishte përrjashtuar. E dhimbshme për të, e dhimbshme për familjen dhe shoqërinë e tij. Megjithatë, u gjet një rrugë për ta zhvilluar shkollimin. U regjistrua në Shkollën e Mesme Ekonomike në Pejë, të cilën edhe e ka kryer me plot sukses. Ai tanimë nuk ishte adoleshent, ishte pjekur dhe i përgatitur për rrugën e vështirë të jetës. Faiku shkon në Pejë si bir i një familjeje të burgosurish politikë. Xhaxhai, Hasan Ukëhaxhaj, i dënuar 11 vjet burg, si profesor i Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri" dhe anëtar i organizatës politike ilegale LNÇKVShJ e udhëhequr nga atdhetari i madh Jusuf Gërvalla. Gjithashtu, edhe vëllai i tij, Isufi, ishte i arrestuar dhe i burgosur për veprimtarinë e tij ilegale. Edhe ai vetë, gjithashtu. Me këtë bagazh ai shkoi në Pejë ku shumë shpejt e gjeti veten mes shokësh dhe vazhdoi rrugën e trasuar të ilegales.

Meqë jam rritur me të dhe pranë tij, mund ta kujtoj çdo ditë të jetës që kemi kaluar bashkë. Mund të shkruaj dhjetëra e qindra faqe për virtytet e tij si njeri, pa e tepruar, them se

mund të shkruaj libër për punën dhe veprimtarinë në të mirë të çështjes kombëtare. Sidomos për vitet 1988, '89 dhe '90-të, në të gjitha ato demonstrata, çdo ditë dhe çdo kund, pa kursyer asgjë nga vetja e tij, shumë herë edhe në rrezik për jetë, e prapë s'ndalej dot. Kujtoj shumë histori që tregojnë karakterin e tij e të papërkulur. Por, çuditërisht, nuk më kujtohet asnjëherë të vetme si rrahagjoks. Për këtë veti të tij të veçantë, besoj se do të flasim ndonjëherë edhe shokët e tij, me të cilët kishte kaluar momente që përshkruhen vetëm nga shokët.

Kujtoj e rikujtoj shumë vite e ngjarje bashkë me këta dy dëshmorë. Por, s'mund të kujtoj ngjarje nga ato ditë të luftës së madhe të vitit 1998, sidomos 2 qershorin e atij viti. Rrugëtimi i jetës në ato vite drejtohej nga momentet dhe jo dëshirat, prandaj kisha lënë atdheun disa vite më para. Arsyet janë të kuptueshme, prandaj nuk e shoh të nevojshme t'i nënvizoj. Por Besimi dhe Faiku, siç e thamë më lart, ishin rritur bashkë në Carrabreg dhe kanë qenë, përveçse kushërinj, edhe shokë të mirë. Dhe lufta i gjeti po aty bashkë. Diçka më ngjanë si në legjenda. Ata ishin dy kundrejt shumë ushtarëve që ishin fshehur e përgatitur për të gjuajtur në luftëtarët e UÇK-së, si një lloj prite, që të kujton heronjtë e vigut. Si duket ata ia kishin ruajtur shpinën njëri-tjetrit deri në momentin e rënies dhe vetëm askush s'e di cili kishte rënë i pari dhe cili kishte provuar t'i merrte hakun për shokun - vëlla. Një gjë dihet: kishin rënë bri njëri-tjetrit.

Në rreshtat e mësipërm pata nënvizuar, se është punë e historianëve për të kërkuar dhe për të gjetur ata bijë e bija që kanë punuar gjatë gjithë jetës derisa në fund kanë dhënë edhe jetën e tyre për Kosovën. Ky shkrim-përkujtim do të doja të ishte një ndihmë modeste për historianët e ardhshëm, të cilët besoj se do ta kompletojnë historinë që do të mbetet e zbehtë pa emrat e atyre që bënë historinë, e ishin pa bujë. Faiku ishte ushtar i asaj armate që kanë vepruar një jetë të tërë për Kosovën, i takon atij rrugëtimi të gjatë me sakrificë deri në rënie me vetëdije të plotë. Mund të jem i gabuar për shkak të informacionit, por nuk më ka rënë të lexoj gjëkund se, përveç Faikut, këtu mund të shprehemi fatmirësisht, nuk kemi ndonjë dëshmor në Komunën e Deçanit të jetë pjesëtar i asaj veprimtarie të shquar ilegale të fillim viteve '80-ta. Në fund dhe jo përfundimisht, në këtë 2 qershor rënien e Besimit dhe Faikut nuk mund ta quaj rënie. Ata të dy dhe gjithë dëshmorët anekënd trojeve shqiptare janë ngritja dhe shkëlqimi i historisë sonë shqiptare.

I përjetshëm kujtimi për dëshmorët!

## Në Pejë ngrihet aktakuzë për falsifikim të certifikatës së veteranit të luftës

PEJË, 1 QERSHOR (ER) - Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën kundër S. H. për veprat penale "Falsifikim i dokumentit" nga neni 398, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe "Legalizim i përmbajtjes së rreme", nga neni 403 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri S. H. më 15 mars 2018 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht në Departamentin për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile zyra në Pejë, fillimisht falsifikon, pastaj me dije përdor dokumentin e falsifikuar dhe atë certifikatën e veteranit dhe vërtetimin e Komisionit Qeveritar, ku me



këtë ve në lajthim organin e lartcekur të cilët, duke menduar se këto janë të vërteta, e vendosin në skemën pensionale dhe veteranëve të luftës. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë, se i pandehuri ka përmbushur elementet e

veprave të përshkruara sikur më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës kompetente që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

## Fehmi dhe Xhevë Lladrovci kurrë nuk pyeten për çmimin lirisë

PRISHTINË, 1 QERSHOR (ER) - Me rastin e 63-vjetorit të lindjes së heroinës, Xhevë Lladrovci, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka organizuar një akademi përkujtimore, në të cilën është thënë se Xheva ishte gruaja e pendës dhe e pushkës, e cila luftoi për lirinë e vendit.

Zëvendësministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Isni Kilaj, ka thënë se Xhevë Lladrovci është një ndër fytyrat më emblematike e të gjitha kohëve. Sipas tij, kjo heroinë nuk kishte siç të ishte ndryshe, pasi doli nga një familje që kishte të brumosur dashurinë për atdheun.

Ndërsa nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të



UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka thënë se heroi Fehmi Lladrovci dhe heroina Xhevë Lladrovci i përkasin gjerdanit të heronjve të atdheut që luftuan për bashkimin dhe lirinë e

shqiptarëve. "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci kurrë nuk pyetën për çmimin e lirisë, pasi ndër të parët iu përgjigjen thirrjes së Adem Jasharit për të luftuar për liri", ka thënë ai.

## KEDS-i zëvendëson rrjetin elektrik të vjetër në Shtime me atë të ri

SHTIME, 1 QERSHOR (ER) - Fshati Petrovë dhe lokaliteti tek udhëkryqi i quajtur "Të Pishat" në Bnicë të Komunës së Shtimes janë dy vendbanimet që kanë përfituar nga investimi i radhës i KEDS-it.

145 familje, të cilat ndër vite kanë pasur probleme të mëdha me tensionin e ulët, si pasojë e rrjetit të vjetër, tashmë janë përfituese të këtij investimi.

Në projektin "Petrova I - Kulla Rashiti" në fshatin Petrovë, që njihet edhe për biznesin e gurëthyesve, gjatë implementimit të projektit, KEDS-i ka vendosur dy trafo, njëra me fuqi prej 400 kVA, tjetra me një kapacitet 250 kVA.



Gjithashtu, janë vendosur 85 shtylla betoni për tensionin e ulët dhe 13 për tensionin e mesëm dhe janë shtrirë 4400m kablo ajrore për tension të ulët dhe

843m kablo nëntokësore për tension të mesëm. Sipas banorëve të fshatit Petrovë, rrjeti elektrik ishte i vjetër që nga viti 1972 dhe gjithmonë paraqiste rrezik.



# Xhevë Krasniqi-Lladrovci, figurë e shquar e luftës çlirimtare të Kosovës



Agim VINCA

Në luftërat për liri të popullit shqiptar në shekuj, krahas burrave, janë shquar edhe gratë. Nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme është i madh numri i vajzave dhe grave që luftuan e sakrifkuan për lirinë e atdheut dhe mbrothësinë e kombit. Xhevë Krasniqi-Lladrovci (1955-1998) është pa dyshim një nga ato gra e vajza që ranë në luftë për çlirimin e Kosovës, duke u bërë gur themeli në godinën e lirisë dhe të pavarësisë së saj.

Xheva lindi dhe u rrit në Drenoc të Malishevës në një familje atdhetare. Babai i saj, Abdyl Krasniqi, ka hyrë në kujtesën tonë kolektive si njeriu që zbuloi eshtrat e heroit Azem Galica, i cili, para se të vdiste nga plagët e marra në përpjekje me xhandarët serbë, u la amanet bashkëluftëtarëve, përfshirë edhe të shoqen, Shotën, që ta varrosnin në fshehtësi në një shpellë. Pas zbulimit të varrit të tij të fshehtë në vitin 1971, 47 vjet pas vdekjes, heroi legjendar u rivarros me nderime në vendlindjen e tij në Galicë.

Xheva u rrit në një familje ku flitej për historinë kombëtare dhe për heronjtë që ranë në altarin e atdheut "rreth flamurit të përbashkuar", për Kosovën dhe bashkimin e saj me Shqipërinë mëmë, ndjenja këto që u ngjizën edhe në shpirtin e njomë të fëmijëve të bacës Abdyl dhe sidomos të vajzës së tij që kishte lindur për t'u bërë edhe vetë heroinë.

Edukatën e marrë në familje vajza e re do ta plotësojë gjatë shkollimit fillor e të mesëm dhe sidomos gjatë studimeve në Universitetin e Prishtinës, ku kreu dy fakultete: Gjuhë e Letërsi Shqipe dhe Shkenca Juridike. Por çast vendimtar në formimin e saj politik e atdhetar do të jetë pa dyshim njohja me njeriun që do të bëhej shoku i saj i jetës dhe i idealit, me Fehmi Lladrovcin (1956-1998).

Nuk mund të flitet, prandaj, për Xhevën pa folur edhe për Fehmiun dhe e kundërta, sepse ata janë një binom i pandarë. Ashtu si Shota dhe Azemi dikur, rreth 80 vjet më parë. Nga dita kur u njohën dhe u

lidhën me një dashuri të pastër për njëri-tjetrin dhe me përkushtimin për atdheun, ata nuk u ndanë më. Jetuan, punuan, vepruan, vuajtën, kënduan, qanë dhe u gëzuan bashkë. Në vendlindje, në Kosovë; në Zagreb, Kroaci, në Evropë, në Zvicër e Gjermani dhe përsëri në vendlindje, në Kosovë, kudo bashkë; në luftë e në beteja. As vdekja nuk i ndau, sepse ata, ashtu siç luftuan bashkë, edhe ranë bashkë, për të shkuar së bashku edhe në pavdekësi. Kur Fehmiu ra në burg, në vitet '80-ta, Xheva shkoi të jetonte në familjen e tij, me prindërit e Fehmiut dhe anëtarët e tjerë të familjes, edhe pse ata ishin vetëm të fejuar. Veprim atipik, sigurisht, i paparë në një mjedisi konservator, çfarë është mjedisi ynë, por heronjtë dhe heroinat i thyejnë rregullat dhe klishtë. Xheva e priti Fehmiun si Penelopa Odiseun në Itakën e saj, në Drenicën kryengritëse, shtatë vjet e gjysmë, derisa u lirua nga burgu në qershor të vitit 1990. Do ta priste edhe aq, përjetësisht, po të ishte e nevojshme. Sepse, Xhevë Krasniqi është një Penelopë shqiptare, por edhe një Zhanë d'Arkë njëkohësisht dhe jo e antikës dhe mesjetës, por e shekullit XX. Xhevë Krasniqi-Lladrovci është gruaja me titullin më të lartë ushtarak në Kosovë: "gjeneralmajore". Pa akademi ushtarake, por me përvojën luftarake të fituar në jetë dhe në front, përkrah bashkudhë-

tarit dhe bashkëluftëtarit të saj të pandashëm, Fehmiut. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci nuk ishin vetëm luftëtarë trima, të gatshëm për sakrificë, por edhe njerëz me përgatitje politike dhe ushtarake.

Në intervistën dhënë "BBC"-së Fehmiu tregon shkaqet politike që çuan në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në shpërthimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, kurse Xheva, në letrat e saj dërguar atij, tregon se ishte vajzë me formim shpirtëror e intelektual për t'u pasur lakmi. Është bërë proverbiale deklarata e Fehmiut dhënë agjencisë prestigjioze angleze pak kohë para se të binte në fushën e betejës: "Vdekja për lirinë e Kosovës do të ishte fati im më i madh jetësor".

Fjalë të mëdha, pa dyshim, zotim sublim! Komandanti sypatrembur i Brigadës "114" fliste jo vetëm në emër të vet, por edhe të gjysmës tjetër të tij, Xhevës. Koha tregoi se ata nuk ishin njerëz të fjalëve, por të veprës, që i qëndrojnë zotimit dhe nuk i bëjnë bisht rrezikut. Në shtator të vitit 1998, kur Serbia ndërmoi ofensivën ushtarake për zhbërjen e UÇK-së, ofensivë së cilës i gëzohej, për turp, edhe një pjesë e shqiptarëve, ithtarët e të ashtuquajturës "rezistencë paqësore", Fehmiu dhe Xheva, nuk pranuan të largoheshin nga pozicionet. Luftëtarët e vërtetë nuk pranojnë t'i dorëzojnë armët, e aq më pak të dorëzohen

vetë, territori i lirë duhej mbrojtur, armikut i duhej treguar se djemtë dhe vashat e UÇK-së e kishin seriozisht dhe ishin të gatshëm për çdo sakrificë. Njëzet vjet më parë, më 22 shtator 1998, Fehmi e Xhevë Lladrovci ranë në fushën e nderit, në afërsi të fshatit Shkabë, bashkë që të dy. Ashtu siç rrugëtuan në jetë dhe në aktivitetin e tyre shumëvjeçar, ashtu u nisën edhe drejt vdekjes dhe - pavdekësisë. Tok, or Marathonomak! Pas rënies së Zahir Pajazitit me shokë dhe sidomos pas epopesë së Prekazit, ky ishte një akt tjetër heroik, që i dha impulse të reja luftës çlirimtare në Kosovë dhe e shpejtoi ditën e çlirimit të saj. Në nëntor të vitit 1998, pak kohë pas rënies së Fehmiut dhe Xhevës, pata shkruar poezinë "Vdekja e luftëtarit". Nuk është e tepërt mbase t'i kujtojmë vargjet e kësaj poezie me këtë rast, në këtë orë përkujtimore. "Thonë se ndërsa po vdiste/ nga plagët e marra në fushë-betejë / diku rrëzë Çiçavicës / komandanti Fehmi Lladrovci / paskësh thënë veç një fjalë: / Po shkoj te Ademi. Te Adem Jashari! / Dhe paskësh mbyllur sytë i qetë, / siç i ka hije një luftëtar. / Lamtumirë Fehmi! / Lamtumirë Adem! / Lamtumirë kapedanë! / Me ju Kosova u bind se kishte bij, / me ju e ndjeu veten Nanë!". Kjo poezi që botuar në nëntor të '98-s në gazetën "Drita" të Tiranës, sepse "Bujku" i shkretë i Prishtinës nuk

botonte në atë kohë poezi si kjo; më vonë e pata përfshirë edhe në librin tim me poezi "Psalmet e rrënjës" (2007). Në librin "Përjetësia e dyfishtë" të Bedri Islamit jepet një e dhënë interesante lidhur me këtë fazë të jetës së Xhevës. Gjatë kohës që Fehmiu ishte në burg në Stara Gradishkë të Kroacisë, nusja e Lladrovëve ia mëson të vjehrrës, nënës së Fehmiut, shkrimleximin, në mënyrë që ajo t'i shkruante të birit me dorën e saj letrën e parë në burg. "I putha ato shkronja një nga një", do të shkruante Fehmiu në përgjigjen e tij. Por, ndërsa po e përgatisja librin për botim, m'u duk se i kisha mbetur borxh Xhevës, andaj shkrova edhe një poezi të shkurtër për të, e cila, ndonëse nuk e ka forcën e të parës, megjithatë thotë diçka për figurën dhe sakrificën e saj: "Xhevë Krasniqi - Lladrovci: Kurrë s'u nda nga i shoqi, Fehmiu. / Mësa Shota nga Azemi. / Lindi veç një fëmijë: / Vajzën e bukur me emrin Liri". Filozofi i madh antik, Platoni, thoshte se kush dëshiron të lindë fëmijë të pavdekshëm duhet t'u drejtohet ideve. A ka ide më të madhe sesa liria e popujve dhe e mbarë njerëzimit? Ata që luftojnë për ideale quhen idealistë, e të tillët zakonisht bien në luftë dhe nuk e presin mbarimin e saj, kur ideat zbehen dhe ndodh që edhe zëvendësohen krejtësisht nga pragmatizmi politik dhe lufta për pushtet. Vetëm të rrallët i rezistojnë tundimit të pushtetit dhe privilegjeve që ofron ai.

1998-2018. Njëzet vjet pas rënies së tyre Kosova është vend i lirë dhe shtet i pavarur por, larg, shumë larg asaj Kosove që e ëndërruan ata që ranë për të, dëshmorët tanë dhe ne të gjallët tok me ta. Në këtë kohë zhgënjimesh dhe mashtrimesh të mëdha, kur veteranë të luftës ndodh të shpallen edhe njerëzit që nuk kanë qenë asnjë ditë në luftë, kurse heroina edhe viktimat e dhunës seksuale, heronjtë e vërtetë si Fehmi Lladrovci dhe heroinat e vërteta si Xhevë Krasniqi-Lladrovci fitojnë peshë edhe më të madhe dhe duhet të na shërbejnë si shëmbëlltyrë. Lavdi u qoftë!

(Fjalë e mbajtur në akademinë përkujtimore kushtuar heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci nën organizim të Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, më 1 qershor 2018)





E rrallë

## Qeni sallam 'fryhet si tollumbac'

Qeni katër vjeç, i quajtur Trevor, përfundoi në këtë gjendje pasi një vrimë në kanalën e frymëmarrjes ia bllokoi ajrin në lëkurën e tij. Kafsha kishte pjesën e trupit të fryrë, por pas një intervenimi kirurgjik e ktheu në gjendje normale. "Ai do të shpërthente si një tullumbac", ka thënë pronari i tij, Fran Jennings.



## BARSOLETA E DITËS



- Polici i troket hajnit në derë.
- Kush është?
- Policia.
- Çfarë dëshironi?
- Dëshëm të flasim pak.
- Sa veta jeni?
- Dy.
- Flisni me njëri-tjetrin pra.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



## FOTO E DITES



Temperaturat kanë arritur rreth 42 gardë celsius në periferi të Jalalabadit në Afganistan. /AFP/

### Në ora 18:00 "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.



## E jashtëzakonshme

### I plotësojnë amanetin, e varrosin brenda makinës

Një person i apasionuar pas makinave në Kinën Jugore ka kërkuar të varrosset brenda një makine pas vdekjes së tij. Ai vdiq të hënën në fshatin e tij në qytetin Baoding në provincën Hebe dhe e



la amanet që trupi i tij të hidhej në makinë, në vend të arkivolit tradicional.

### Në ora 22:00 "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




#### DASHI

Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt, sot është mirë t'i merrni dhe t'i diskutoni me qetësi ngjarjet e fundit që kanë ndodhur.



#### DEMI

Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.



#### BINJAKËT

Nëse keni marrë përsipër të përshkoni një rrugë të caktuar, nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.



#### GAFORRJA

Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të momentit. Do të jetë më mirë të kërkonti këshilla tek personat e duhur.



#### LUANI

Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të detyruar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkonti mendimin e familjes.



#### VIJGJËRËSHA

Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që ju ka bërë partneri.



#### PESHORJA

Momenti më i mirë i dietës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktive dhe energjike.



#### AKREPI

Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.



#### SHIGJETARI

Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë problem.



#### BRICJAPI

U bë kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.



#### UJORI

Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.



#### PESHQIT

Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë nuk kanë qëllime negative karshi jush.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AUSTRIA - GERMANY

2

ENGLAND - NIGERIA

1

ICELAND - NORWAY

2

## Prishtina, 'kampione' e transferimeve

Argjend Mustafa të premten është prezantuar në skuadrën e Prishtinës, kurse ish-shokët e tij në skuadrën e Trepçës '89, Bledar Hajdini dhe Fiton Hajdari, janë prezantuar te Llapi. Prishtina i ka mbyllur transferimet, kurse Llapi dhe skuadrat e tjera pritet të janë aktive edhe gjatë ditëve të ardhshme

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Skuadra e Prishtinës ka reaguar fuqishëm pas mbylljes së kampionatit 2017/2018, duke transferuar brenda javës plot pesë futbollistë cilësorë. Dy prej tyre, Ahmet Haliti dhe Armend Thaqi, ishin pjesë e kësaj skuadre edhe në të kaluarën, kurse për herë të parë fanellën "bardhekaltër" do ta bartin Meriton Korenica, Leotrim Bekteshi dhe transferimi i së premtes, Argjend Mustafa. 24-vjeçari nga Theranda ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën kryeqytetase, kurse shpreh optimizëm se në edicionin e ri Prishtina do të shpallet kampione e Superligës. "Zgjidhja për të nënshkruar me Prishtinën ishte shumë e lehtë dhe u përmbush pas disa tentimeve dhe dëshirës për të qenë pjesë e klubit më të madh në vend. Prishtinën e shoh si pretendente kryesore për titull dhe së bashku kam shumë besim se

do t'ia arrijmë qëllimit", ka thënë Mustafa, i cili gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Ballkanin, Ramiz Sadikun, Trepçën, Trepçën '89 dhe Skënderbeun. Ndërsa skuadra më e madhe në vend nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se transferimet për Ligën e Evropës kanë përfunduar, eventualisht mund të bëhet edhe një transferim nga jashtë Kosovës për repartin e sulmit. Siç dihet, Prishtina e mbylli kampionatin në pozitën e dytë me tri pikë më pak se Drita e Gjilanit, kurse në finale të Kupës doli fitimtare përballë skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova.

### Hajdini dhe Hajdari zyrtarizohen te Llapi

Aktive të premten është treguar edhe skuadra e Llapit, e cila prezantoi dy transferimet për edicionin e ri futbollistik 2018/2019. Bëhet fjalë për portierin Bledar Hajdini dhe sulmuesin Fiton Hajdarin, të cilët në edicionin e fundit ishin



pjesë e skuadrës së Trepçës '89. 22-vjeçari është pjesë e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, kurse në edicionin e kaluar pati paraqitje tejet të mira duke mbajtur plot 18 herë portën e paprekur, ndërsa gjatë edicionit 2016/18 arriti të shpallej kampion me Trepçën '89 ku edhe mori pjesë në garat e Ligës së Kampionëve. Ndërsa Fiton Hajdari është 26-vjeçar dhe njihet për golin historik të shënuar në Ligën e Kampionëve për Trepçën '89. Skuadra e Llapit rrezikon të

humbasë dy yje që shkëlqyen në kampionatin e fundit, Mentor Zhdrellën dhe Hamdi Namanin. Për Zhdrellën interesim kanë treguar Drita dhe Feronikeli, kurse për Namanin besohet se ka arritur marrëveshje me skuadrën nga Drenasi dhe në fund të qershorit do të zyrtarizohet.

### Besa aktive, por afër të humbas Qorrajn

Besa e Pejës po tregohet skuadër aktive pas rënies në

Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Kjo skuadër fillimisht arriti marrëveshje me trajnerin Ismet Munishi, kurse tash është shumë afër marrëveshjes me Dugagjin dhe Kushtrim Gashin. Drejtuesit e klubit pejan kanë kontaktuar edhe ish-lojtarët: Albert Dabiqaj, Arber Prekazi, Fisnik Papuqi dhe Kastriot Rexha. Megjithatë, nga Peja pritet të largohet gjatë ditëve në vijim mesfushori i talentuar Floren Qorraj. Ky i fundit po kërkohet nga Flamurtari i Vlorës.

## Ministri Gashi kërkon maksimumin nga Drita në garat ndërkombëtare



**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të premten në takim Klubin e Futbollit "Drita" të Gjilanit, i cili fitoi titullin e kampionit në Superligën e Kosovës në futboll për sezonin 2017/18. Ministri i ka uruar futbollistët dhe drejtuesit e klubit për suksesin e arritur. Ai vlerësoi se me angazhim dhe

vullnet mund të arrihet deri te suksesi siç edhe kanë arritur. Sipas njoftimit të MKRS-së, ministri Gashi ka kërkuar nga futbollistët dhe përfaqësuesit e klubit që në përfaqësimet ndërkombëtare ta japin maksimumin dhe ta prezantojnë Kosovën sa më me dinjitet. Ai u premtoi mbështetjen e plotë të MKRS-së edhe në të ardhmen.

Ndërkaq, përfaqësuesit e Klubit të Dritës falënderuan ministrin Gashi për mikpritjen, urimin dhe gatishmërinë e treguar për ta mbështetur klubin. Ata premtojnë se në garat ndërkombëtare që do të marrin pjesë do ta përfaqësojnë në mënyrën sa më të mirë të mundshme jo vetëm klubin dhe qytetin e tyre, po edhe Kosovën.

## Krasniqi sonte përballet me Kashtanovin

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Boksieri shqiptar Haxhi Krasniqi do të luftojë sonte (e shtunë) për titullin më të lashtë të

Evropës në boks, EBU European Championship, në kategorinë super të mesme 76 kg. Dueli do të zhvillohet

në Bayern të Gjermanisë, kurse kundërshtar i shqiptarit do të jetë Stanislav Kashtanov. 31-vjeçari nga

Juniku në karrierën e tij të boksit ka zhvilluar 52 ndeshje dhe ka realizuar 47 fitore dhe 5 humbje.





## Khaka: Do të luaj në Botërorin 'Rusia 2018'

CYRIH, 1 QERSHOR - Mesfushori i Kombëtares së Zvicrës me prejardhje nga Kosova, Granit Xhaka, ka pësuar një lëndim në stërvitje me këtë kombëtare. Xhaka ka kryer kontrolle më të

hollësishme mjekësore dhe mjekët e Kombëtares së Zvicrës kanë konstatuar se lëndimi i tij nuk është serioz dhe se ai do të jetë i gatshëm për Kupën e Botës. Vetë Xhaka e ka konfir-

muar një gjë të tillë në faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Zvicrës, ku ka thënë: "Jam i lehtësuar pasi kuptova se do të luaj në Botëror". Xhaka është lënduar pas një dueli me shqip-

tarin tjetër, Valon Behrami por, për fatin e mirë, lëndimi nuk është serioz. Mesfushori i Arsenalit pritet të mungojë në miqësoren që Zvicra e luan ndaj Spanjës të dielën.



# Veseli dhe Gjimshti: Këndellemi ndaj Ukrainës

